

CURRICULUM VITAE



1. Të dhëna personale

<i>Emri:</i>	Arta
<i>Mbiemri:</i>	Vorpsi
<i>Titulli:</i>	Doktor i Shkencave Juridike (Dr.iur)
<i>Datëlindja:</i>	26/06/1974
<i>Shtetësia:</i>	Shqiptare
<i>Gjendja civile:</i>	E martuar

2. Mundësi kontaktimi:

<i>Adresa private:</i>	Rr.Siri Kodra, Nr.71/1, Ap.8, 1017 Tiranë
<i>Adresa e punës:</i>	Blv.Dëshmorët e Kombit, Nr.26, 1001 Tiranë
<i>Tel privat:</i>	Cel.+355 68 20 90 610
<i>Tel zyre:</i>	+355 422 259 052
<i>Email privat:</i>	arta.vorpsi@gmail.com
<i>Email zyre:</i>	arta.vorpsi@gjk.gov.al

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

3. Arsimimi:

<i>Instituti dhe kohëzgjatja</i>	<i>Grada ose diploma e fituar:</i>
Universiteti i Vjenës-Shtator 1999- Mars 2001	<i>Doctor iuris</i> (Dr.iur.):Mbrotjtja e disertacionit dhe marrja e titullit “ <i>Doktore e shkencave juridike</i> ” (Dr.iur.) Tema e disertacionit: “ <i>Shteti i së drejtës dhe kontrolli kushtetues. Vështrim krahasues mbi teorinë e shtetit të së drejtës dhe Gjykatën Kushtetuese të Austrisë dhe të Shqipërisë</i> ”.
Universiteti i Vjenës Tetor 1998- Qershor 1999	Njësimi i diplomës me sistemin studimor austriak dhe marrja e titullit “ <i>Magjistër i Shkencave Juridike (Magister)</i> ”. Fusha e studimit: E drejtë kushtetuese, e drejtë administrative dhe e drejtë europiane.
Universiteti i Tiranës 1992-1996	Studime universitare, Marrja e diplomës “ <i>Jurist</i> ”.
Universiteti i Hamburgut 1994-1995	Studime universitare, ndjekja e rregullt e leksioneve dhe seminareve në fushat: e drejtë administrative, e drejtë europiane dhe e drejtë civile si dhe kalimi me sukses i provimeve në këto lëndë.
Shkolla e Mesme Pedagogjike 1988-1992	Marrja e diplomës “ <i>Mësues i ciklit të ulët</i> ”

4. Aftësi profesionale:

- Mbi 22 vjet përvojë në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe të administratës publike. Përvojë të gjatë në përgatitjen e analizave ligjore dhe në hartimin e akteve normative (dispozita kushtetuese, ligjore, nënligjore, rregullore të brendshme, urdhra etj.).
- Njohuri të thella mbi sisteme të ndryshme ligjore si dhe të standardeve më të mira europiane dhe ndërkombëtare. Njohje shumë të mira të së drejtës publike europiane dhe të së drejtës së krahasuar.

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

- Aftësi analitike shumë të mira sa i takon zbërthimit të aspekteve të ndryshme ligjore dhe qasjen e tyre në kontekstin vendas.
- Njohje shumë të mira në fushën e përafrimit të legjislationit shqiptar me atë të BE-së si dhe kriterëve të plotësimit të standardeve ndërkombëtare që rrjedhin nga ratifikimi i konventave ndërkombëtare në fusha të tilla si: e drejta penale, e drejta procedurale penale, mbrojtja e fëmijëve (pornografia e fëmijëve, trafikimi i fëmijëve, kujdestaria e fëmijëve dhe politikat penale ndaj fëmijëve), çështje të dhunës në familje dhe të barazisë gjinore, antidiskriminimit, çështje të administratës publike, trafikimit të qenieve njerëzore dhe strategjive antikorruption, etj.
- Përvojë mjaft e gjatë në përgatitjen e materialeve, moduleve dhe kurrikulave për mësimdhënie në programet bachelor dhe master si dhe trajnime të ndryshme për administratën publike, gjyqtarë e prokurorë.
- Aftësi mjaft të mira të shkruarit akademik si dhe të shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

5. Aftësi gjuhësore:(shkalla nga 1 deri në 5, 1 shkëlqyeshëm - 5 njohuri bazë)

Gjuha	Lexim	E folur	E shkruar
Shqip (gjuha amtare)	1	1	1
Anglisht (nivel profesional)	1	1	1
Gjermanisht (nivel profesional)	1	1	1
Italisht (nivel baze profesional)	2	2	2

6.Aftësi të tjera:

- Aftësi mjaft të mira organizative dhe komunikuese;
- Aftësi për të punuar individualisht ose në grup;
- Aftësi për t'iu përmbajtur afateve të caktuara si dhe cilësisë së detyrës;
- Njohuri dhe përdorim shumë të mirë të kompjuterit
- Leje drejtimi automjeti e tipit B.

7. Veprimtari profesionale

- Këshilltare ligjore e gjyqtarëve, Gjykata Kushtetuese;
- Lektore e së drejtës kushtetuese, të drejtës kushtetuese të krahasuar, të drejtave të njeriut;
- Eksperte për trajnimin e administratës publike pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike;
- Eksperte për trajnimin vazhdues gjyqtarëve dhe prokurorëve pranë Shkollës së Magjistraturës.
- Hartuese projektaktesh (dispozita kushtetuese, ligjore dhe nënligjore)

8. Veprimtari të tjera:

- Gjyqtare ad hoc pranë Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, Francë.
- Anëtare e Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ ndaj shtetit shqiptar.
- Anëtare e Bordit Shkencor për botimin e posaçëm të materialeve parlamentare të reformës në drejtësi
- Anëtare e Bordit Shkencor për përgatitjen e komentarit elektronik mbi disa nga ligjet e pushtetit gjyqësor, projekt i EURALIUS IV dhe Shkollës së Magjistraturës
- Eksperte ligjore e pavarur në mjaft projekte vendase dhe ndërkombëtare.
- Anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare për të Drejtën Kushtetuese (Anëtare aktive në Grupin Kërkimor për Ndryshimet Kushtetuese);
- Anëtare e Shoqatës së Europës Juglindore (Mynih, Gjermani).
- Anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare për të Drejtën Publike (IACL)

9. Përvojë pune

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Institucioni</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Përshkrimi i punës</i>
Prej 2005	Gjykata Kushtetuese	Këshilltare ligjore	- Përgatitja e relacioneve për çështje në gjykim; - Hartimi i projektvendimeve të Gjykatës; - Përgatitje e analizave mbi çështje të ndryshme ligjore; - Kërkime mbi praktikën më të mira të gjykatave kushtetuese europiane, të GJEDNJ-së dhe GJED-së; - Detyra të tjera të ngarkuara nga Kryetari dhe gjyqtarët e Gjykatës lidhur me procesin vendimmarrës.
2001-2005	Gjykata Kushtetuese	Drejtoresë së Studimeve dhe Botimeve	- Përgatitja e analizave mbi gjendjen dhe zhvillimin e sistemit juridik shqiptar dhe të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese; - Përgatitja e materialeve mbi vendimet më të fundit të gjykatave kushtetuese europiane si dhe të GJEDNJ-së; - Përgatitja e botimeve periodike të Gjykatës si dhe të botimeve të tjera të posaçme, të shoqëruara me indeksin dhe/ose analiza; - Organizimi dhe përgatitja e konferencave shkencore të organizuara nga Gjykata Kushtetuese në bashkëpunim me gjykatat kushtetuese europiane ose Komisionin e Venecias dhe organizata të tjera vendase dhe të huaja.
Prej 2009	Shkolla e Magjistraturës	Trajnere e gjyqtarëve dhe prokurorëve	Përgatitja e modulit dhe materialeve për trajnime mbi çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut si p.sh: - Ankimi Kushtetues Individual para dhe pas reformës kushtetuese 2016 - Aspekte të procesit të rregullt ligjor në këndvështrimin e praktikës së Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së; - Zbatimi i parimit ne bis in idem nga gjykatat, në këndvështrimin e praktikës së GJEDNJ-së.

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Institucioni</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Përshkrimi i punës</i>
Prej 2004	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)	Trajnere	- Përgatitja e modulit dhe materialeve për trajnime mbi çështje kushtetuese, të të drejtave të njeriut, transparencës së administratës publike dhe të të drejtës për informim. - Përgatitja e bankës së pyetjeve për testim përfundimtar të nëpunësve civilë pjesëmarrës në trajnim.
Prej 2003	Fakulteti i Drejtësisë	Lektore	- Përgatitja e kurrikulave, moduleve, leksioneve (power point dhe word) për nivelin e studimeve bachelor dhe master, në lëndët: e drejtë kushtetuese; e drejtë publike; e drejtë kushtetuese e krahasuar; të drejtat e njeriut. - Udhëheqëse shkencore dhe opONENTE e studentëve të nivelit të bachelor, master dhe doktoraturë për mbrojtjen e diplomave dhe titujve shkencorë.
Prej janarit 2017	UNDP	Eksperte ligjore	- Analizë dhe vlerësimi i mangësive dhe sugjerime për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional për realizimin e së drejtës së aksesit në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. - Eksperte për hartimin e projektligjit të ri për Ndhëm Juridike të Garantuar nga Shteti dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. - Asistimin e ngritjes së qendrave për ofrimin e ndihmës juridike falas.
Gusht 2017- janar 2018	Këshilli i Europës	Eksperte ligjore	Trajnuese e administratës publike mbi çështjet Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut (Business and Human Rights) në BE dhe përgatitjen e <i>amicus curia</i> për gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare nga institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut (Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit).
Janar-dhjetor 2018	OSFA	Eksperte ligjore	Anëtare e grupit të ekspertëve për përgatitjen e një komentari mbi ndryshimet kushtetuese të reformës në drejtësi 2016
Nën-Dhjet. 2016	UNWOMEN	Eksperte ligjore	Përgatitja e raportit të parë të monitorimit të shtetit shqiptar në kuder të zbatimit të Konventës së Stambollit.
Korrik-Dhjetor 2016	Këshilli i Europës	Eksperte ligjore	- Përgatitja e analizës mbi kuadrin ligjor për antidiskriminimin. - Hartimi i rekomandimeve për ndryshime dhe plotësime në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. - Hartimi i dispozitave konkrete ligjore dhe akteve të tjera të nevojshme për përmirësim.

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Institucioni</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Përshkrimi i punës</i>
Jan.2015- Dhjetor 2016	Kuvendi i Shqipërisë	Eksperte ligjore pranë Sekretariatit Teknik të Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë	- Anëtare e Nëngrupit për Reformën Kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese. - Përgatitja e analizave ligjore për situatën në të cilën ndodhet sistemi i drejtësisë, duke evidentuar mangësitë dhe nevojën për reformim. - Përgatitja e materialeve krahasimore mbi modelet më të mira europiane për Shqipërinë dhe dhënia e sugjerimeve përkatëse për Komisionin parlamentar. - Hartimi i projekt-amendamenteve kushtetuese dhe i projekt-amendamenteve ligjore.
Prej 2015	GJEDNJ	Gjyqtare ad hoc	Gjyqtari ad hoc zëvendëson gjyqtarin e zgjedhur të GJEDNJ në rastet kur ai është i pamundur ose ka pengesë ligjore të marrë pjesë në gjykimin e çështjeve para GJEDNJ.
Prill- Qershor 2015	UNICEF- Terre des Hommes	Eksperte ligjore	- Përgatitja e analizës së thellë ligjore mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. - Evidentimi i mangësive dhe nevoja për amendime ligjore sa i takon kuadrit ligjor për ndalimin e shfrytëzimit dhe të trafikimit të fëmijëve.
Tetor 2015- Korrik 2016	UNICEF	Eksperte ligjore	Hartimi i projektligjit të ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në Republikën e Shqipërisë.”
Tetor 2015- qershor 2016	UNICEF	Eksperte ligjore	Koordinatorë për monitorimin e dokumentimit të iniciativës për programin global për mbrojtjen e fëmijëve online.
Janar-Prill 2015	Instituti për Studime Ligjore	Eksperte ligjore	- Përgatitje e një përmbledhje të shkurtuar dhe të indeksuar të jurisprudencës së gjykatave shqiptare mbi lirinë e shprehjes. - Analiza mbi pajtueshmërinë e praktikës gjyqësore vendase me standardet e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Institucioni</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Përshkrimi i punës</i>
Dhjetor 2013-Shkurt 2014	Instituti për Studime Ligjore	Eksperte ligjore	- Përgatitja e një raporti vlerësimi për rishikimin e Kushtetutës shqiptare. - Përgatitja e një analize të thellë ligjore mbi zhvillimin kushtetues në vende të ndryshme të Europës.
Dhjetor 2012-Qershor 2013	Komisioni European	Eksperte ligjore	- Përgatitja e një analize të thellë ligjore për evidentimin e boshllëqeve në sistemin e brendshëm juridik mbi çështje të tilla si: shteti i së drejtës, antikorupsioni, trafikimi i qenieve njerëzore etj. - Hartimi i amendamenteve ligjore për ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale me qëllim përafrimin e tyre me <i>acquis communautaire</i> , konkretisht me Kapitullin 24 "Justice and Home Affairs".
Prill-Maj 2013	UNICEF	Eksperte ligjore	Asistencë në përgatitjen e legjislacionit për punonjësit socialë dhe psikologët.
Tetor-Nëntor 2012	Shërbimi Social Shtetëror	Eksperte ligjore	Përgatitja e moduleve dhe realizimi i trajnimit mbi kujdestarinë e fëmijëve për personelin e shërbimeve të kujdestarisë në Shqipëri.
Nëntor 2012-Shkurt 2013	UNWOMEN Ministria e Drejtësisë	Eksperte ligjore	Përgatitja e moduleve dhe realizimi i trajnimit mbi regjimet martesore sipas së drejtës familjare. Trajnim për shërbimin e noterisë publike.
Janar 2011	Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Fondacioni IRZ	Eksperte ligjore	Përgatitja e moduleve dhe realizimi i trajnimit për këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Temat e trajnimit: shteti i së drejtës, e drejta e informimit publik nga këndvështrimi i gjykatës.
Shkurt-Qershor 2011	EURALIUS	Eksperte ligjore	Hartimi i projekt-dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, në kuadër të masave antikorupsion dhe antitrafikim, si element i domosdoshëm i para-anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Institucioni</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Përshkrimi i punës</i>
Dhjetor-Tetor 2010	UNDP	Eksperte ligjore	- Përgatitja e analizës mbi pajtueshmërinë dhe përafrimin e legjislacionit të brendshëm me CEDAW dhe akte të tjera ndërkombëtare mbi çështje të barazisë gjinore. - Përgatitja e projekt-dispozitave ligjore për dhunën në familje dhe diskriminimin me bazë gjinore.
Korri-Nëntor 2009	OSBE	Eksperte ligjore	- Përgatitja e analizës mbi situatën ligjore të fëmijëve nën 14 vjeç që janë në konflikt me ligjin. - Propozimi i masave ligjore dhe sociale për përmirësimin e situatës, me qëllim shmangien e kufizimit të lirisë së tyre dhe rehabilitimin social për këtë kategori.
Korrik 2006-Dhjetor 2010	Ministria e Kulturës	Eksperte ligjore	- Hartimi i projektligjit mbi lirinë e besimit fetar. - Hartimi i marrëveshjeve midis Këshillit të Ministrave dhe Bashkësive Fetare në Shqipëri.
Prill-Qershor 2008	UNICEF	Eksperte ligjore	- Përgatitja e analizës ligjore mbi penalizimin e pornografisë së fëmijëve dhe plotësimin e dispozitave përkatëse të Kodit Penal për këtë çështje. - Hartimi i dispozitave ligjore penale materiale dhe procedurale kundër pornografisë dhe trafikimit të fëmijëve.
Gusht-Tetor 2007	UNDP-UNIFEM	Eksperte ligjore	Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit mbi masat kundër dhunës në familje.
Qershor-Shtator 2006	USAID	Eksperte ligjore	- Hartimi i ligjit mbi konfliktin e interesit të zyrtarët e lartë. - Përgatitja e manualit për zbatimin e ligjit për konfliktin e interesit të zyrtarëve të lartë. - Përgatitja e moduleve dhe materialeve si dhe realizimi i trajnimit të stafit të ILDKPKI-së mbi ligjin e ri për konfliktin e interesit.
1996-1998	Dhoma e Avokatisë Tiranë	Avokate	Përgatitja e materialeve mbi çështje të ndryshme ligjore dhe përfaqësimi i tyre para gjykatës së shkallës së parë.

10. Botime:

Libra

1. *"Komentar mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë 2016"*. Botim i Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Institutit për Studime Publike dhe Ligjore. Bashkëautore. Tiranë 2019.
2. *"Human Dignity in Albania" in: Handbook of Human Dignity in Europe*. Eds. Klaus Mathis, Paolo Becchi, University of Lucerne. Springer International (available as e-book, foreseen to be published in Hardcover in 2019).
3. *"Constitutional Justice in Albania" in: Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism*. Ed. Rainer Arnold. Springer International Publishing (to be published in 2018).
4. *"The Impact of proportionality test in protecting individual rights in: Constitutional Justice and Evolution of Individual Rights"* Bashkëautore, Eds. Rainer Arnold, Alexandru Tanase. Universitaetsverlag Regensburg (2018).
5. *"Ankimi Kushtetues Individual – Përvoja gjermane dhe perspektiva shqiptare (Die Verfassungsbeschwerde – Aus deutscher und albanischer Perspektive)"*. Handbook, coauthor. Ed. German Foundation for International Legal Cooperation-IRZ. (2017)
6. *"Constitutional Courts and Ordinary Courts: Cooperation or Conflict?"*, Libër, Bashkëautore Eds. Rainer Arnold, Herbert Roth, Universitaetsverlag Regensburg (2017).
7. *"Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power"*. Bashkëautore, Eds. Rainer Arnold, Jose' Ignacio Martinez-Estay. Springer International Publishing (2017).
8. *"Transformation of Law Systems in Central, Eastern and Southeastern Europe in 1989-2015"*. Bashkëautore, Gdansk University Press (2016).
9. *"Limitations of National Sovereignty through European Integration"*, Editor: Rainer Arnold, Springer Verlag, 2016 (Bashkëautore).

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

10. *"Recent Developments in Albanian Constitutional Law"* Universitetii Regensburgut, Gjermani, 2012 (Monografi).
11. *"Parime kushtetuese dhe të drejtat e njeriut në praktikën e Gjykatës Kushtetuese"* Tiranë, 2012 (Bashkëautore).
12. *"Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë"*, Shtëpia Botuese "Maluka", Tiranë, 2011 (Monografi).
13. *"Rechtsstaat und Verfassungsgerichtsbarkeit – Ein vergleichender Ueberblick ueber oesterreichische und albanische Verfassungsgerichtsbarkeit"*, Universiteti i Vjenës, Austri, 2001 (Disertacioni).

Artikuj

1. *"Mbi përgjimin personal dhe të banesës si kufizim i privatësisë"* – reflektime mbi vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane. Jeta Juridike Nr.1/2017, Shkolla e Magjistraturës, fq.147.
2. *"Constitutional Justice and Politics – The review of constitutional amendments by the Constitutional Court in Albania"*, Raport i mbajtur në: XVIII International Congress on European and Comparative Constitutional Law, 14-15 October 2016, University of Regensburg.
3. *"Konstitucionalizimi i së drejtës private dhe qasja e gjykatave shqiptare"*, Jeta Juridike Nr.4/2015, Shkolla e Magjistraturës.
4. *"Constitutional courts and ordinary courts – Cooperation or conflict? Referat i mbajtur në Kongresin eXVII Ndërkombëtar për të Drejtën Kushtetuese Europiane*, Universiteti i Regensburgut, Gjermani 2015.
5. *"The influence of the Albanian Constitution in Private Law"*, Report held at XVIth International Congress on European and Comparative Constitutional Law, 13-14 October 2014, University of Regensburg.

Curriculum Vitae – Arta Vorpsi

15. *"Raporti kushtetues President – Parlament në Republikën parlamentare"*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.29/2006.
16. *"Referendumi shfuqizues dhe shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese"*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.31/2006.
17. *"Mbi hapësirën e kontrollit të GjK lidhur me shqyrtimin e konflikteve zgjedhore sipas nenit 131/e të Kushtetutës"*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.35/2007.
18. *"Interpretimi i Kushtetutës nga Gjykata Kushtetuese-Vendime interpretuese"*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.24/2005.
19. *"Kuptimi i termit "interes i tyre" nga këndvështrimi i partive politike, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës"*, botuar në revistën Tribuna Juridike, Nr.51/2004.
20. *"International protection of freedom of religion (Mbrotjtja ndërkombëtare e lirisë së besimit)"*, botuar në revistën Tribuna Juridike, Nr.46/2004.
21. *"Për imunitetin"*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.19/2004.
22. *"Kur është vendimi i Kuvendit akt normativ?-opinion mbi një vendim të Gjykatës Kushtetuese"*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.21/2004.
23. *"Partitë politike dhe financimi i tyre nga shteti"*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.16/2003.
24. *"equality before law in the jurisprudence of Albanian Constitutional Court"*, botuar në revistën Jeta Juridike, Nr.1/2003.
25. *"Cronical of Albanian Constitutional Court's jurisprudence"*, in Constitutional Law Review of East-European countries, University d'Auvergne, Law Faculty Clermont-Ferrand, Nr.2/2001.

Këshilltare Ligjor në Gjykatën së Lartë

Aulona BODO u lind më 25 Shtator 1980. Në vitin 2004 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ka ushtruar profesionin e juristit në pozicionin e sekretarit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më pas ka vijuar si jurist pranë Shoqërisë Albtelekom sh.a, duke mbuluar përfaqësimet ligjore të kësaj kompanie në gjykatë. Në vijim ajo ka mbajtur pozicionin e Kryetarit të Degës Juridike pranë Universitetit të Tiranës, Rektorati. Nga muaji Janar 2008 deri në muajin nëntor 2012 ka punuar pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, fillimisht si inspektor në Drejtorinë e Kthimit të Pronës, më pas Koordinator për çështjet e njohjes së kthimit dhe kompensimit të pronave në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për çështjet e njohjes dhe kthimit të pronave, dhe më pas, ka mbajtur detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Shqyrtimit për Çështjet e Njohjes dhe Kthimit të Pronave për tre qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës. Në vitin 2013 ka punuar fillimisht si Specialist i Zhvillimit të Programeve të Granteve dhe më pas ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Zhvillimit të Programeve të Granteve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit në Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Në periudhën Shkurt-Nëntor 2014, Znj. Bodo ka qenë pjesë e grupit Task Forcës së ngritur *“Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore”*, në cilësinë e ekspertës së nivelit të lartë të kontraktuar nga Qeveria Shqiptare për çështjet e pronësisë dhe regjistrimit të titujve të pronësisë. Nga muaji nëntor 2014 e në vijim, Znj. Bodo ka qenë ndihmëse ligjore pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, më pas Këshilltare Ligjore në Kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Znj. Bodo në vitin 2012 ka marrë Diplomën MASTER-Niveli i dytë në të Drejtën Civile, lëshuar nga Shkolla e Lartë Private “ILLYRIA”, Fakulteti i Drejtësisë. Në muajin Maj 2019, Znj. Bodo ka përfunduar me sukses programin SAL “School of American Law”, pranë *School of American Law*, Athen-Greece, cila përbën edhe fazën e parë të kualifikimi për të vijuar fitimin e titullit Master LL.M in “*U.S., International and Transnational Law*”, Chicago-Kent College of Law, Illinois Institute of Technology, USA .

Znj Bodo është angazhuar në veprimtaritë mësimdhënëse në vitin 2007 pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Fakulteti Biznes-Turizëm, Dega Drejtësi, Vlorë. Ajo zotëron gjithashtu edhe titullin “Avokat”.

Këshilltar Ligjor i Gjykatës së Lartë

Besmir Rrapaj ka lindur më 04 gusht 1985. Është i martuar dhe ka një fëmijë. Në vitin 2004-2008 kreu studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, duke u diplomuar “Jurist”.

Në vitin 2010 ka mbrojtur titullin Avokat, pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë. Për periudhën 2011 – 2014 ka ushtruar profesionin e avokatit dhe juristit. Në vitin 2015 është emëruar dhe ushtron detyrën e Këshilltarit Ligjor të Gjykatës së Lartë, si dhe prej vitit 2019 ushtron edhe detyrën e Këshilltarit Ligjor, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Këshilltar ligjor i Gjykatës së Lartë

Edlira Llango ka lindur në Çorovodë, më 6 Maj 1980. Është e martuar dhe nëna e një djali.

Në vitet 1998-2004 ka kryer studimet universitare për drejtësi pranë Universitetit të studimeve të Romës, “La Sapienza”, Itali. Gjatë kësaj periudhe ka ndjekur disa kurse universitare shumëdisiplinor për edukimit dhe zhvillim: *“Përjashtimi social: paragjykimet dhe diskriminimet”* (Viti akademik 2003-2004); *“Azili Politik: Nga Konventa e Gjenevës në Kushtetutën Evropiane”* (Viti akademik 2003-2004); *“Emigrazioni dhe Azili Politik: Bashkimi Evropian dhe Rajoni i Mesdheut”* (Viti akademik 2004-2005).

Në Vitin akademik 2004-2005 ka kryer studimet pasuniversitare në “Mbrotjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut”, pranë Universitetit të studimeve të Romës, “La Sapienza”, Itali.

Në periudhën Maj 2006 – Dhjetor 2007 ka punuar si juriste pranë Komunës Qendër Skrapar. Në periudhën 2008-2013 ka ushtruar profesionin pranë sektorit privat. Nga Shkurti i vitit 2014 deri në Mars të vitit 2016 ka qenë Drejtor i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik. Në periudhën Gusht 2018 – Shtator 2019 ka qenë Drejtor i Drejtorisë së Legjislacionit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në vitin akademik 2019 – 2020 ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës, në profilin Këshilltar Ligjor.

Me Vendimin nr. 555, datë 12.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar Këshilltare Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë.

Eranda HYSI u lind më 07 Janar 1984. Ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet 2002-2006. Ajo zotëron gjithashtu edhe titullin “Avokat”.

Nga Janari 2007 deri më Tetor 2020, ka ushtruar profesionin e juristit në pozicionin e sekretarit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vitet 2020-2021, ka ndjekur programin e formimit fillestar për Këshilltarë Ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 486, datë 19.10.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Znj. Hysi, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Këshilltare Ligjore e Gjykatës së Lartë

Evriklejda SEMANI u lind në Berat, më 12 Nëntor 1985. Ajo është e martuar dhe ka një vajzë.

Ka kryer studimet e larta në Drejtësi në vitet 2004-2008 në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës. Nga tetori i vitit 2009 deri në tetor të vitit 2014 ka ushtruar profesionin e juristit pranë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. Nga tetori i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2019 ka ushtruar profesionin e Avokatit të Shtetit pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit.

Në vitin akademik 2019 - 2020 ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës, në profilin Këshilltar Ligjor.

Me vendimin Nr.557 datë 12.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Znj.SEMANI, Këshilltare Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Këshilltar i Gjykatës së Lartë

Gerti SHANI u lind në Lushnje, më 8 mars 1981. Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë. Ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet 2002-2006.

Nga muaji janar 2008 deri në muaji qershor 2015, ka ushtruar profesionin e Avokatit pranë Dhomës Avokatisë Lushnje.

Në datë 18.06.2015 emërohet Ndhmës Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, deri më 07.10.2019.

Në vitet 2019-2020, ka ndjekur programin e formimit fillestar për Këshilltarë Ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 556, datë 12.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Z. SHANI, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Aktualisht mban postin e Drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Ka lindur në vitin 1982, është i martuar dhe ka një vajzë.

Është diplomuar për Inxhinieri Elektronike në Universitetin e Inxhinierisë Pedagogjike dhe Teknologjike (ASPAITE), në Athinë, Greqi në vitin 2008. Në vitin 2009 ka përfunduar studimet Master në Inxhinieri Elektronike pranë këtij universiteti në Athinë. Ka punuar prej disa vitesh si inxhinier elektronik dhe mesues i inxhinierisë elektronike në shtetin Grek. Prej vitit 2009 – 2015 ka punuar si Koordinator i projekteve PAP, BKT, SCHOOL PROJECT dhe menaxher i Qendrës së Operimit, si edhe Drejtor Teknik në disa shoqëri shqiptare në fushën e telekomunikacionit dhe teknologjisë. Prej 5 vitesh ka ushtuar detyrën e specialistit të IT pranë Shkollës së Magjistraturës, deri në vitin 2020 e më pas këtë detyrë e ka ushtruar edhe pranë Këshilli të Lartë Gjyqësor.

Ka marrë pjesë në trajnime kombëtare e ndërkombëtare në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Zotëron dy gjuhë të huaja: greqisht dhe anglisht.

Këshilltar Ligjor i Gjykatës së Lartë

Laureta Nezaj ka lindur më 06 mars 1980. Është e pa martuar. Në vitin 1998-2002 kreu studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, duke u diplomuar “Jurist”.

Në vitin 2004 ka mbrojtur titullin Avokat, pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë. Për periudhën 2004 – 2008 ka ushtruar profesionin e avokatit. Për periudhën nga viti 2008 -2010 ka ushtruar detyrën specialist jurist dhe përgjegjëse e Sektorit të Shqyrtimit dhe Vlerësimit, pranë Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Tiranë. Nga viti 2010 -2013 ka ushtruar detyrën e inspektorit jurist dhe përgjegjësit të Sektorit të marrëdhënieve me Publikun pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në vitin 2013 është emëruar dhe ushtron detyrën e Këshilltarit Ligjor të Gjykatës së Lartë, gjithashtu prej janarit të vitit 2019 ushtron edhe detyrën e Këshilltarit Ligjor, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Këshilltar i Gjykatës së Lartë

Metush MEÇKA u lind në Lushnje, më 7 nëntor 1982. Ai është i martuar dhe ka një fëmijë. Ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet 2001-2005.

Nga muaji nëntor 2007 deri në muaji tetor 2019, ka ushtruar profesionin e Avokatit pranë Dhomës Avokatisë Lushnje.

Në vitet 2019-2020, ka ndjekur programin e formimit fillestar për Këshilltarë Ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 554, datë 12.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Z. MEÇKA, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Miran Kopani

Miran Kopani u lind Tiranë më 27.05.1971. Në vitet 1990-1995 ka studiuar në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Në vitet 1996-1998 ka punuar si jurist në Drejtorinë Ligjore pranë Departamentit të Shtetit të Postave dhe Telekomunikacionit. Në vitin 1998 deri në vitin 2000 ka punuar si jurist pranë Bankës Kombëtare Tregtare. Në vitin 2000 ka nisur punën si specialist pranë Drejtorisë së Organizimit Gjyqësor dhe specialist pranë Drejtorisë së Legjislacionit dhe dhe Asistencës Ligjore, në Ministrinë e Drejtësisë deri në vitin 2008. Më pas, është emëruar Drejtori i Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore, Departamenti i Përgjithshëm i Kodifikimit, në këtë Ministri, deri në vitin 2010. Po në këtë vit ka marrë detyrën e Drejtorit të Studimeve Ligjore, Publikimeve dhe IT, pranë Gjykatës së Lartë, të cilën e ka ushtruar deri në vitin 2014. Prej vitit 2014 e në vazhdim mban detyrën e Këshilltarit Ligjor, në Kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.

Këshilltar i Gjykatës së Lartë

Nertila Ndrejoni ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2009 dhe prej vitit 2013 është në proces doktorature.

Prej vitit 2010 emërohet në detyrën e Këshilltares Ligjore pranë Gjykatës së Lartë, detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht.

Në vitin 2014, ka marrë titullin Avokat, pasi ka kryer testimin përkatës pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Prej vitit 2013 është pjesëmarrëse aktive në trajnime të ndryshme të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës si edhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë që operojnë në fushën e së drejtës në Shqipëri, si OPDATE, Këshilli i Evropës, si edhe aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga ambasadat e huaja në Tiranë si ajo Britanike, Hollandeze, etj.

Këshilltar i Gjykatës së Lartë

Zef MACAJ u lind në Mirditë, më 17 Shtator 1982. Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë. Ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në vitet 2001-2005 dhe në 2005 ka marrë Diplomën “Jurist”.

Në vitet 2009-2011 ka kryer studimet pasuniversitare pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe në 2011 ka marrë Diplomën “MASTER-Niveli i dytë në Shkenca Juridike Civile”.

Gjatë periudhës 2008-2012 ka kryer disa kurse trajtimi, sikurse trajnimi i kryer në vitin 2008 në “Administration of Justice”, të organizuar EVD Agency for International Business and Cooperation & T.M.C Asser Instituut, Hagë, Holandë, si dhe trajnime të tjera, të kryera pranë Institutit të Administratës Publike, sot Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Në periudhën Maj 2007 – Dhjetor 2007 ka punuar si Jurist pranë Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Qarku Lezhë.

Në periudhën Prill 2008 – Qershor 2012 ka qenë Inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, Ministria e Drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe është angazhuar si ekspert afatshkurtër në projektin “Balkans Enforcement Reform Project”, të drejtuar nga Center for International Legal Cooperation (CILC) and Open Regional Fund for Legal Reforms of the German (GIZ), si dhe ka qenë pjesë e grupeve të punës pranë misionit EURALIUS, në projektin “Consolidation of the Justice System in Albania”, me cilësinë e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Nga muaji Qershor 2012 deri në muajin tetor 2020, ka ushtruar profesionin e përmbaruesit gjyqësor privat dhe administrator i Zyrës të Përmbarimit Albius. Gjatë kësaj periudhe ka mbajtur disa detyra pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, si anëtar i Këshillit Drejtues (2014-2018), Kryetar i Këshillit Drejtues (2014-2015), si dhe Nënkryetar i Dhomës (2018-2020).

Z. Macaj është angazhuar në veprimtarinë mësimëdhënëse në vitin 2006 pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Ai zotëron gjithashtu edhe titullin “Avokat”.

Në vitet 2020-2021, ka ndjekur programin e formimit fillestar për Këshilltarë Ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 487, datë 19.10.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Z. MACAJ, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.